



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 06.05.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 02.05.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Toifor Shpk" për aktivitetin: "**Mirembajtja dimerore e rrugeve dhe trotuareve , deblokimi i kanalizimit atmosferik**" dhe me numër të prokurimit: 616 -18-025-211 nxjerr:

VENDIM

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "Toifor Shpk" e datës 02.05.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit "**Mirembajtja dimerore e rrugeve dhe trotuareve , deblokimi i kanalizimit atmosferik**" me Nr. 616 18 440 211 Nr. Brendshëm : 616 -18-025-211 kundër njoftimit të vendimit të AK –së, të datës 26.04.2019 të publikuara në web-faqe të KRPP-së.
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin sipas publikimit të datës 26.04.2019 .
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik "Toifor Shpk" me datë 02.05.2019 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: ' "**Mirembajtja dimerore e rrugeve dhe trotuareve , deblokimi i kanalizimit atmosferik**"' me numër të prokurimit Nr. 616 18 440 211 dhe numër të brendshëm 616 18 025 211.

Autoriteti Kontraktues, me datë 06.05.2019, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Lidhur me pretendimin tuaj për anulimin paraprak të lotit 3 ju sqarojmë se në Vendimin e OSHP-së që është përpiluar në bazë të ankesës tuaj askund nuk ceket se AK-ja ka anuluar të njëjtin pa bazë ligjore, por ka kërkuar që për të gjitha lotet të bëhet trajtim i barabartë i OE-ik

dhe këtë AK-ja e ka bërë me rastin e rivlerësimit dhe ka cekur se AK-ja nuk ka dhënë arsyetim për të njëjtën,por arsyetimi ka qenë i qartë me qëllim që të rivlerësohen të gjitha pjesët dhe të gjindet kombinimi i propozimeve në harmoni me kriterin e FDT-së-çmimi më i ulët si që është vepruar edhe në vlerësimin e fundit;

-Pretendimi juaj se OE-ik "Dardania" nuk plotëson kriteret teknike të tenderit është plotësisht i pa bazuar sepse në tenderin e vet ky OE-ik ka dorëzuar dëshmitë edhe për tri cisterna tjera të cilat kanë vëllim mbi 7.0 m3 dhe poashtu komisioni i rivlerësimit gjatë inspektimit ka konstatuar se i njëjti posedon të gjitha mjetet e paraqitura,ndërsa për mjetet që kanë qenë jashtë Kosovës ka pranuar inçizimet-videot dhe i ka trajtuar si të pranueshme.Ua përkujtojmë se të gjitha mjetet e inspektuara janë nga lista e dorëzuar me tenderin e OE-ik,siqë janë edhe mjetet tjera-makina speciale për pastrim të shesheve dhe për deblokim të kanalizimeve;

-Pretendimi lidhur me OE-ik "Dardania"për mosplotësimin e kërkesave për lotet 3 dhe 6 është jo vetëm i pa bazuar,por në kundërshtim me të gjitha vendimet dhe njoftimet që janë publikuar lidhur me vlerësimin e këtij aktiviteti,pasiqë në asnjë rast tenderi i i të njëjtit nuk është eliminuar,por është trajtuar vetëm i pa suksesshëm dhe atë në vlerësimin e parë pasiqë kombinimi i çmimeve më të lira për lote e ka pa mundur që të jetë pjesë e kombinimit të propozimeve për dhënje të kontratës.Për sqarim plotësues ua rikujtojmë se për mosplotësim të kërkesave në këtë pjesë janë eliminuar OE-ik "Pastrimi"dhe "VZ Company";

-Në vlerësimin e dytë në bazë të pretendimeve të OE-ik "Dardania"dhe në bazë të vizitave të komisionit asnjë OE-ik nuk i është krijuar ndonjë favor,por përkundrazi vlerësimi është kryer në raport me të gjitha kërkesat e tenderit e posaçërisht në harmoni me dëshmitë e paisjeve të kërkuara dhe për mungesë të më shumë se katër OE-ik të përgjegjshëm dy lotet :3 dhe 6 janë anuluar për arsyen e thjeshtë që sipas kriterit nga FDT-ja:çmimi më i ulët për katër lote të propozohet kombinimi i çmimit më të ulët.

-Për shkak të stërzgjatjes së afateve si rezultat i ankesave Autoriteti kontraktues është detyruar të kërkoj vazhdimin e vlefshmërisë së ofertave dhe sigurimit të tenderit dhe kjo ka ndodhur edhe me rastin e vlerësimit të fundit.Pas kësaj kerkese OE-ik "Vemor"është deklaruar për vazhdimin e vlefshmërisë së tenderit vetëm për pjesën 6 dhe kështu nuk është trajtuar i përgjegjshëm për pjesët tjera dhe kjo ka kushtëzuar që i njëjti të mund të rekomandohet eventualisht për dhënje të kontratës vetëm për atë pjesë.

Bazuar në faktin se tenderi juaj është eliminuar që në fillim për pjesën 2 dhe në faktin se OE-ik "Vemor"ka vazhduar vlefshmërinë e tenderit vetëm për pjesën 6,Autoriteti Kontraktues duke respektuar kriterin e FDT-së ka propozuar kombinimin e çmimit më të ulët dhe si rezultat i atij kombinimi ju jeni propozuar për dhënje të kontratës për pjesën e parë.

Bazuar ne sqarimet paraprake kerkesa juaj per ri-shqyrtim refuzohet si e pa bazuar.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit